

# ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA E PODUJEVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **615-25-804-5-1-1**

Sa i përket tenderit për **“Asfaltimi i rrugës Llapashticë-Popovë”**

## ANKESË

### 1. Identifikimi i ankuesit\*

BENI - COM SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Shkabaj, Obiliq

(Adresa)

Obiliq

(Vendi)

045/444999

(Numri Telefonit)

15000

(Kodi postar)

-

(Numri i Faks-it)

Muhamet Kunushefci

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

beni-com@hotmail.com

(Adresa elektronike)



02.01.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

### 2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës e parashtron ankesën përmes përfaqësuesit zyrtar të kompanisë.

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Autoriteti Kontraktues KOMUNA E PODUJEVËS për aktivitetin e prokurimit “Asfaltimi i rrugës Llapashticë-Popovë” me nr. prokurimi: 615-25-804-5-1-1, ka publikuar këto njoftime:

1. Publikimi i Njoftimit për kontratë me datë 14.02.2025  
Procedurë e hapur  
Lloji i kontratës – Punë  
Vlera e parashikuar – 1,624,500.00€  
Kriteri për dhënien e kontratës : Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët  
Afati i fundit për dorëzimin e tenderit me 07.04.2025
2. Njoftim Vendimi i AK-së i dt. 18.06.2025
3. Kërkesa për rishqyrtim mbi vlerësimin fillestar i dt. 21.06.2025
4. Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim i dt. 24.06.2025
5. Ankesa në OSHP mbi vlerësimin fillestar i dt. 04.07.2025
6. Vendimi i PSH me nr. 2025/0601 i dt. 17.09.2025 përmes të cilit është aprovuar ankesa e OE ankues “BENI – COM SH.P.K.”, është anuluar vendimi për dhënien e kontratës dhe është obliguar AK që lëndën ta kthejë në rivlerësim dhe ti vlerësoj dhe krahasoj tenderët e përgjegjshëm sipas kriterëve për dhënien e kontratës të përcaktuara në njoftimin e kontratës/dosjen e tenderit.
7. Njoftim Vendimi i AK-së për rivlerësimin e parë i dt. 07.11.2025
8. Kërkesa për rishqyrtim mbi rivlerësimin e parë i dt. 12.11.2025
9. Vendimi mbi aprovimin e pjeshëm të kërkesës për rishqyrtim i dt. 12.11.2025
10. Njoftim Vendimi i AK-së për rivlerësimin e dytë i dt. 16.12.2025
11. Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim 23.12.2025

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

## 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

*Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-së.*

Pas analizimit të këtyre dokumenteve mund të thuhet se gjatë procedurës formale të vlerësimit të tenderëve që kanë marrë pjesë në këtë aktivitet prokurimi, nxjerrjes së vendimeve kontradiktore, AK nuk ka zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme dispozitat ligjore procedurale dhe materiale të LPP-së për shkak se gjatë mënyrës dhe metodës së vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve, nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit dhe dispozitat ligjore që përcaktojnë kushtet dhe kërkesat e trajtimit të barabartë të OE në procesin e vlerësimit.

Pas kësaj ne kemi vazhduar me kërkesë për rishqyrtim pranë AK e dorëzuar me datë 22.12.2025 derisa përgjigja na është kthyer me datë 23.12.2025 në bazë të vendimit me të cilin AK nuk i ka marrë parasysh argumentet tona për vlerësimin kundërligjor që është bërë në lidhje me këtë AP dhe në të njëjtën kohë ka vazhduar me shkelje tjera të rënda të LPP-së si dhe legjislacionit sekondar Rregullores për Prokurim Publik Nr. 002/2024. Si rrjedhojë në i drejtohem OSHP-së në mënyrë që të parandalojmë shkeljen e Ligjeve në fuqi nga AK.

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Parashtruesi i ankesës, konsideron se nga ana e AK-së, KOMUNA E PODUJEVËS, vlerësimi për këtë aktivitet të prokurimit është bërë në kundërshtim me parimet e prokurimit publik, rrjedhimisht duke shkelur dispozitat përkatëse të LPP-së Nr. 02/L-042 (verzioni i konsoliduar) si ligj material dhe legjislacionit sekondar Rregullores për Prokurim Publik Nr.002/2024 , në mënyrë specifike dispozitat si më poshtë:

- Neni 1 par. 1 dhe 2 të LPP-së
- Neni 2 të LPP-së
- Neni 7 të LPP-së
- Neni 24 par. 2 dhe 3 të LPP-së
- Neni 52 par. 1 dhe 3 të LPP-së
- Neni 56 paragrafi 1.1, 1.2 dhe 3 të LPP-së
- Neni 57 të LPP-së
- Neni 59 par. 1, 2 dhe 4 të LPP-së
- Neni 60 par. 1.1 të LPP-së
- Neni 69 të LPP-së
- Neni 71 par.2 të LPP-së
- Neni 72 të LPP-së
- Neni 4 të RrPP-së
- Neni 26 të RrPP-së
- Neni 28 të RrPP-së
- Neni 30 të RrPP-së
- Neni 38 të RrPP-së
- Neni 39 par. 4 të RrPP-së
- Neni 40 par. 1, 2, 3 dhe 6 të RrPP-së
- Neni 97 par. 1.o) të RrPP-së
- Dispozita nr. 9 dhe 10 të UPP-së

Njëkohësisht AK me rastin e refuzimit të kërkesës për rishqyrtim ka bërë shkelje edhe të **Nenit 108/A të LPP-së.**

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

### Historia procedurale e çështjes së aktivitetit në fjalë

1. Me datën 14 Shkurt 2025, AK – “KOMUNA E PODUJEVËS” përmes platformës publike e-prokurimi ka shpallur iniciimin e aktivitetit të prokurimit me titull: “Asfaltimi i rrugës Llapashticë-Popovë” me nr. prokurimi: 615-25-804-5-1-1.
2. Kompania jonë, pra Operatori Ekonomik BENI COM SH.P.K. ka marrë pjesë në këtë aktivitet të prokurimit në grup me OE ETEAM SH.P.K. & LINDA duke dorëzuar dosjen e tenderit brenda afatit të përcaktuar ligjor dhe duke i plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit.

Në këtë aktivitet të prokurimit janë pranuar pesë (5) oferta, të cilat janë:

Nr.	Operatori Ekonomik	Çmimi (me TVSH)
1	NNT ABC SH.P.K.	1,352,847.15 €
2	Grup i Operatorëve Ekonomik BENI - COM SH.P.K.; ETEAM SH.P.K.; Linda	1,470,620.69 €
3	Grup i Operatorëve Ekonomik FS C ING SH.P.K.; EL-BAU SH.P.K.	1,544,942.14 €
4	Rahovica Commerce SH.P.K.	1,552,730.86 €
5	Grup i Operatorëve Ekonomik Quality Asphalt SH.P.K.; N.N.SH. ËORLD MEDIUM; CAPITAL X FET SH.P.K.	1,731,305.93 €

3. Autoriteti Kontraktues me datën 18.06.2025 ka bërë publikimin e Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, tek i cili vendim AK rekomandon për shpërblim me kontratë **Grupin e Operatorëve Ekonomik FS C ING SH.P.K.; EL-BAU SH.P.K.** dhe ofertën tonë e refuzon si të papërgjegjshme duke mos zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme dispozitat ligjore procedurale dhe materiale të LPP-së.
4. Menjëherë pas pranimit të këtij Vendimi ne kemi bërë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare me dt. 18.06.2025 ku pastaj qasja është mundësuar me datën 19.06.2025. Ne pastaj kemi vazhduar me kërkesë për rishqyrtim e cila u refuzuar nga ana e AK-së për të vazhduar me ankesë në OSHP.
5. OSHP me anë të vendimit të dt. 17.09.2025 e aprovon kërkesën tonë si pjesërisht të bazuar dhe lënden e kthen në rivlerësim.
6. Pas pranimit të këtij vendimi, AK nuk nxjerr asnjë vendim deri me datë 07.11.2025 pra plot 52 ditë nga vendimi i OSHP-së.
7. Më 07.11.2025, AK publikoi vendimin e radhës, i cili ishte i pritshëm. Duke mos e zbatuar vendimin e OSHP-së dhe duke përsëritur shkeljet e mëparshme, AK kësaj radhe vendosi për shpërblim me kontratë një OE tjetër të papërgjegjshëm: Rahovica Commerce SH.P.K.  
Menjëherë pas pranimit të këtij vendimi për rivlerësimin, më 09.11.2025, ne kemi dorëzuar kërkesë për qasje në dokumentet zyrtare. Kjo qasje është realizuar më 10.11.2025, ku kemi pasur mundësinë të shqyrtojmë dokumentacionin përkatës të procedurës së rivlerësimit të parë. Ne pastaj kemi vazhduar me kërkesë për rishqyrtim e cila është aprovuar pjesërisht nga ana e AK-së dhe lënda është kthyer në rivlerësim

prapë.

8. Më 16.12.2025, AK publikoi vendimin e radhës, i cili ishte poashtu i pritshëm. Duke mos e zbatuar vendimin e OSHP-së dhe duke përsëritur shkeljet e mëparshme, AK kësaj radhe vendosi të rekomandoj anulimin e procedurës në mungesë të ofertave të përgjegjshme.
9. Menjëherë pas pranimit të këtij Vendimi ne kemi bërë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare me dt. 16.12.2025 ku pastaj qasja është mundësuar me datën 17.12.2025.

Pas analizimit të këtyre dokumenteve mund të thuhet se gjatë procedurës formale të vlerësimit të tenderëve që kanë marrë pjesë në këtë aktivitet prokurimi, nxjerrjes së vendimeve kontradiktore, AK nuk ka zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme dispozitat ligjore procedurale dhe materiale të LPP-së për shkak se gjatë mënyrës dhe metodës së vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve, nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit dhe dispozitat ligjore që përcaktojnë kushtet dhe kërkesat e trajtimit të barabartë të OE në procesin e vlerësimit.

Në vazhdim do të ofrojmë një deklaratë të qartë, të detajuar dhe të faktuar me argumente të bazuara dhe mbështetshme për secilën nga pretendimet ankimore që do t'i parashtrojmë në këtë "Ankesë" kundrejt vendimit të AK sipas të cilave mund të vëreni shumë lehtë se AK ka vepruar në kundërshtim me LPP-në duke mos i përfillur kërkesat që vet i ka parashtruar në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë lidhur me kriteret e përzgjedhjes dhe kriterit të dhënies së kontratës duke shkelur parimet bazike dhe parimet e vlerësimit të prokurimit.

### **Përshkrimi faktik dhe ligjor i pretendimeve ankimore**

#### **Pretendimet për shkelje procedurale/materiale gjatë veprimeve dhe aktvendimit të AK-së për refuzimin si të pabazuar të kërkesës për rishqyrtim**

Nga ana e Sektorit të Prokurimit të AK-së, përmes vendimit të datës 23.12.2025 te e cila është refuzuar si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruar nga ne me një arsyetim të përgjithshëm dhe të paargumentuar me asnjë fakt dhe provë konkrete.

Gjatë procedurës së shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim nga ana e AK-së kanë ndodhur një mori shkelje procedurale dhe materiale të cilat do t'i paraqesim në vijim:

**Konstatimet** e paraqitura në të gjitha pikat e vendimit të AK-së janë të mangëta dhe si të tilla nuk janë të bazuara dhe argumentuara me faktet vendimtare në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara nga ne, kërkesave të dosjes së tenderit dhe dispozitave ligjore të LPP-së. Nga ky vendim shihet qartë se AK i ka trajtuar shkarazi dhe në mënyrë selektive pretendimet dhe argumentet e paraqitura në kërkesën për rishqyrtim, ashtu që duke u shmangur detyrimeve ligjore dhe duke i anashkaluar faktet vendimtare dhe rrethanave të rastit konkret ka paraqitur pasqyrim të gabuar të gjendjes faktike që nuk përkon me realitetin, rrjedhimisht që e ngatërrojnë gjendjen e saktë faktike dhe përshkrimit ligjor në mënyrë që të na mohoj të drejtën në rivlerësim të drejtë të procesit, me qëllim që të ipet përshtypja se asgjë e paligjshme nuk ka ndodhur. Prandaj, ky arsyetim i vendimit të atakuar nuk e ka vërtetuar saktë dhe drejtë gjendjen faktike dhe

rrjedhimisht është zbatuar në mënyrë të gabuar e drejta e dispozitave materiale të LPP-së (Neni 108/A) përfshirë edhe keqinterpretimi i tyre dhe kërkesave të dosjes së tenderit. Sepse arsyet e dhëna në vendimin e AK-së nuk janë të bazuar në baza ligjore sipas dispozitave të LPP-së dhe pjesës përbërëse të legjislacionit dytësor RRPP Nr.001/2022. Për më tepër arsyetimi i vendimit të AK-së është në kundërshtim edhe me përcaktimet e nenit 48 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

### **Përshkrimi faktik dhe ligjor i pretendimeve ankimore**

#### **Pretendimet ankimore mbi Vendimin e AK-së i datës 16.12.2025**

##### **Pretendimi i parë (I)**

Autoriteti Kontraktues ofertën tonë e cilëson si të papërgjegjshme me arsyetimin se:

Gjatë vlerësimit është konstatuar se operatori ekonomik BENI COM SH.P.K. nuk i ka dëshmuar pajisjet me foto sipas kërkesës.

Konkretisht: Për cilindrin me dhëmbëza (min. 21.5 ton), dëshmia e ofruar nga OE nuk është në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit, pasi:

OE ka ofruar marrëveshje me kompaninë EUROVIA, e cila nuk përmban DUD-in doganor që vërteton se cilindri është me dhëmbëza;

OE BENI COM ing i ndërtimitaris – konstruktiv 5 vite përvij, te jet e zspert i siguris ne pune. Mungon qertifikimi per ekspert per siguri dhe shendet ne pune.

Këto arsytetime nuk janë të bazuara dhe nuk e pasqyrojnë realitetin dhe gjendjen faktike por si të tilla paraqesin fakte të rreme me qëllim të justifikimit të këtij vendimi i cili është në kundërshtim me parimet dhe kriteret e nenit 59, nenit 69 të LPP-së lidhur me nenin 40 paragrafi 1,2 dhe 6 të RrPP nr. 002/2024.

**1.** Fillimisht sa i përket arsyetimit të parë të eliminimit tonë lidhur me: *Cilinder me vemza për ngjeshje me peshë min. 21.5 ton*, ky arsyetim nuk qëndron për dëshmitë në vijim:

Kërkesa e përcaktuar në FTD ka qenë: **Lista e pajisjeve - mjeteve të punës që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas Aneksit 7**

**Dëshmia Lista e paisjeve e nënshkruar dhe vulosur original nga OE, të dhënat e paisjeve, Librezat me validitet për makinerin që regjistrohet, Dud , Faturë, Foto për pajisjet e tjera. Apo marrveshje makinerisë Originale në mes të Qeradhënësit dhe Qeramarrësit**

Nr.	Lloji i pajisjeve dhe mjeteve të punës	Sasia e kërkuar (cope)
15	Cilinder me vemza për ngjeshje me peshë min. 21.5 ton	1

Duke u bazuar në kërkesën e përcaktuar në FTD, ne kemi dorëzuar pajisjen me të dhënat "BOMAG BW 225-D3", nëpërmjet marrëveshjes me kompaninë "EUROVIA SH.P.K."

Në DUD-in doganor për këtë pajisje nuk është specifikuar qartë se ajo është "me vemza", mirëpo kjo nuk mund të konsiderohet si mangësi, pasi në dokumentet doganore nuk pasqyrohen gjithmonë të gjitha karakteristikat teknike të detajuara të pajisjeve. Ky element

teknik dëshmoheh përmes fotografive të pajisjes.

Vlen të theksohet se as për operatorin ekonomik të rekomanduar për kontratë dhe as për ndonjë ofertues tjetër, në DUD-in doganor nuk është specifikuar ky detaj teknik, ngase në praktikë ai dëshmoheh përmes fotografive dhe të dhënave vizuale të pajisjes.

Për këtë arsye, ne kemi paraqitur fotografi të modelit të ofruar "BOMAG BË 225-D3", vetëm për të ilustruar dhe vërtetuar se i njëjti model është cilindër me vëmza, që përmbush plotësisht kërkesën e përcaktuar në Dosjen e Tenderit.

AK në këtë rast ka bërë shkelje edhe të Nenit 72 të LPP-së më saktësisht të paragrafit 2 ku kemi: "*Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji*". E njëjta parashihet edhe tek Rregullorja nr. 002/2024 më saktësisht tek Neni 38, por një gjë të tillë nuk e ka bërë duke na diskriminuar dhe duke shkelur nenin 7 dhe nenin 59 të LPP-së, konkretisht nenin 59 par. 1 të LPP-së.

Pra AK ka vlerësuar padrejtësisht ofertën tonë si të papërgjegjshme me arsyetim se nuk kemi plotësuar kërkesa të cilat nuk kanë qenë pjesë e dosjes së tenderit kështu duke bërë shkelje të Nenit 52, Nenit 59.2, Nenit 59.4, Nenit 72.1, Nenit 72.2 të LPP-së si dhe Nenit 40.1 të RrPP-së. Poashtu AK ka bërë shkelje edhe të Nenit 56 të LPP-së më saktësisht të paragrafit 3 ku kemi: "*Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit*".

Mirëpo AK duke pasur qëllim dhe shkas të caktuar para vetes eliminimit tonë me çdo kusht dhe arritjen e rezultatit të dëshiruar për këtë aktivitet të prokurimit, pa dhënë asnjë shpjegim dhe arsye të bazuar mbi faktet vendimtare dhe dispozitat ligjore të LPP-së shkel parimet e drejtësisë dhe arsyes njerëzore, duke abuzuar qëllimisht me detyrën zyrtare ndërmerr masa të jashtëligjshme në kundërshtim me kërkesat procedurale dhe qenësore të legjislacionit të prokurimit me qëllim të eliminimit të parashtruesit të ankesës dhe krijimit të rrethanave për të krijuar një rezultat.

Sa i përket fotografisë, vlen të theksohet se edhe në kërkesën për rishqyrtim, ne kemi sqaruar qartë se fotografitë e bashkëngjitura nuk janë paraqitur si dëshmi përfundimtare e pajisjes konkrete, por vetëm si ilustrim teknik i modelit "BOMAG BW 225-D3", me qëllim të dëshmimit se ky model, sipas specifikimeve të prodhuesit, është cilindër me vëmza (xhemba) dhe përmbush kërkesën e përcaktuar në Dosjen e Tenderit. Për më tepër, për të shmangur çdo paqartësi artificiale të krijuar nga AK, në Aneksin 1 të kësaj ankese në OSHP bashkëngjiten fotografi reale të pajisjes konkrete të ofruar, të cilat dëshmojnë qartë dhe pa asnjë dyshim se pajisja e ofruar është cilindër me vëmza (xhemba) dhe se përputhet plotësisht me modelin e deklaruar "BOMAG BW 225-D3". Përgjigja e AK-së ndaj kërkesës për rishqyrtim është formale, e përgjithshme dhe nuk adreson asnjë nga sqarimet konkrete të dhëna nga OE, veçanërisht faktin se fotografitë janë paraqitur vetëm për identifikim modeli, ndërsa AK nuk ka kërkuar asnjëherë dëshmi shtesë për pajisjen reale, ndonëse këtë e lejon dhe e obligon Neni 72 i LPP-së. Për rrjedhojë, eliminimi i ofertës sonë për këtë arsye nuk mbështetet as në Dosjen e Tenderit, as në ligj dhe as në fakte, por përbën një

interpretim të njëanshëm dhe të qëllimshëm të dokumentacionit, me synim nxjerrjen e një rezultati të paracaktuar në këtë aktivitet të prokurimit.

*Dëshmi 1: Aneksi 1 (Fotografitë e pajisjes dhe tiketa, BOMAG BW 225-D3).*

Oferta jonë është e plotë dhe e saktë me të gjithë dokumentet e saj shoqëruese në përputhje me të gjitha kriteret dhe dokumentet (dëshmitë) e tenderit të përcaktuara nga AK në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit.

2. Sa i përket arsytimit të dytë të eliminimit tonë lidhur me: *Mungon certifikimi për ekspert për siguri dhe shëndet në punë për inxhinierin e ndërtimtarisë - konstruktiv*, ky arsyetim nuk qëndron për dëshmitë në vijim:

Kërkesa e përcaktuar në FTD ka qenë: **Kërkesa-2 Një (1) Inxhinier të diplomuar ose Bachelor të Ndërtimtarisë - drejtimi Konstruktiv, me së paku 5 (Pesë) vite përvojë pune pas diplomimit. Të jetë i certifikuar licencuar nga MPMS dhe MFPT, si Ekspert për Siguri dhe shendet në punë.**

**Dëshmi: Ndersa per Inxhinierin ose Bachelorin e Ndertimtarise deshmi edhe Certifikaten e siguris dhe shendetit në pune**

Duke u bazuar në kërkesën e përcaktuar në FTD, ne kemi dorëzuar dëshmitë për inxhinierin e kërkuar dhe dëshmia është e qartë dhe e qasshme tek pjesa: **(05 Stafi profesional – 2. Inxh. konstruktiv – i certifikuar – doc. te NOTERIZUARA).**

Pra ne kemi dëshmuar se i njëjti posedon certifikatën e lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale me nr. regjistri të certifikatës 232 dhe e cila vërteton se i njëjti ka dhënë provimin profesional për Siguri dhe Shëndet në Punë me datë 12.12.2020.

*Dëshmi 2: Aneksi 2 (Certifikata për siguri dhe shëndet në punë e lëshuar nga MPMS).*

AK në këtë rast ka bërë shkelje edhe të Nenit 72 të LPP-së më saktësisht të paragrafit 2 ku kemi: *“Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji”*. E njëjta parashihet edhe tek Rregullorja nr. 002/2024 më saktësisht tek Neni 38, por një gjë të tillë nuk e ka bërë duke na diskriminuar dhe duke shkelur nenin 7 dhe nenin 59 të LPP-së, konkretisht nenin 59 par. 1 të LPP-së.

Oferta jonë është e plotë dhe e saktë me të gjithë dokumentet e saj shoqëruese në përputhje me të gjitha kriteret dhe dokumentet (dëshmitë) e tenderit të përcaktuara nga AK në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit.

### **Pretendimi i dytë (II)**

AK ka bërë shkelje të rëndë Neni 97.1.h. pasi nuk ka respektuar vendimin e OSHP-së nr. 2025/0601 pasi sipas këtij vendimi të gjitha arsyetimin e eliminimit tonë janë hudhur poshtë nga Paneli Shqyrtues dhe gjatë rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit, AK prapë ka kthyer vlerësimin në pikën 0.

Pra, lidhur me pretendimet ankimore sipas ankesës 2025/0601, Paneli Shqyrtues ka gjetur

se arsyet për eliminimin tonë nga AK janë të pabazuara dhe jo konform dispozitave ligjore siç i parasheh neni 7 i LPP dhe dispozitave të RRPP-së i cili është akt nënligjor që rregullon procedurat në një AK, konkretisht AK ka vepruar në kundërshtim me Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve 40 parag. 1 dhe neni 40 parag.2 dhe nënparag.1 i këtij *“Kurdo që aktiviteti i prokurimit kthehet në rivlerësim në bazë të një kërkesë të OE për rishqyrtim të vendimit të AK-së, AK e kthen lëndën në rivlerësim për të korigjur parregullsitë e mundshme ligjore. Kurdo që aktiviteti i prokurimit kthehet në rivlerësim në bazë të një vendimi të OSHP-së, rivlerësimi bëhet për të korigjur parregullsitë e mundshme ligjore sipas vendimit të OSHP-së. Rivlerësimi i tenderëve mund të bëhet nga i njëjti komision, i cili ka kryer vlerësimin e tenderëve”*. Ne pretendojmë se AK gjatë rivlerësimit ka qenë dashur të veproj konform këtyre dispozitave ligjore dhe jo ta kthej aktivitetin në rivlerësim prej fillimit të procedurës (nga pika 0).

Andaj AK ka bërë shkelje të këtyre dispozitave ligjore të lartë përmendura, ngase AK siç u potencua më lartë nuk ka korigjuar parregullsitë e mundshme ligjore sipas vendimit paraprak të OSHP-së por ka paraqitur arsye të reja në lidhje me eliminimin tonë.

**Sa i përket vlerësimin të ofertave tjera në këtë aktivitet si të papërgjegjshme ne në këtë rast pajtohemi me AK mirëpo kemi edhe disa pretendime shtesë në lidhje me papërgjegjshmërinë e tyre të cilat do i paraqesim në vijim.**

**Sa i përket eliminimit të OE NNT ABC SH.P.K. në këtë rast pajtohemi me vendimin e AK-së se të njëjtit janë të papërgjegjshëm dhe se të njëjtit nuk mund të klasifikohen si palë me interes material në kuptim të nenit 4.1.26 të LPP-së.**

**Sa i përket eliminimit të GOE Quality Asphalt SH.P.K.; N.N.SH. ËORLD MEDIUM; CAPITAL X FET SH.P.K. në këtë rast pajtohemi me vendimin e AK-së se të njëjtit janë të papërgjegjshëm dhe se të njëjtit nuk mund të klasifikohen si palë me interes material në kuptim të nenit 4.1.26 të LPP-së.**

**Pretendimet ankimore ndaj GOE FS C ING SH.P.K.; EL-BAU SH.P.K.**

### **Pretendimi i tretë (III)**

AK ka bërë shkelje edhe të Nenit 59.4 të LPP-së lidhur me Nenin 40 të RrPP-së pasi nuk ka potencuar të gjitha mungesat në ofertën e GOE FS C ING SH.P.K.; EL-BAU SH.P.K. pasi i njëjti është i papërgjegjshëm për arsye tjera pasi nuk plotëson kriteret e vendosura në FTD-në e këtij aktiviteti të prokurimit.

GOE me rastin e ofertimit ka dorëzuar paramasën në të cilën shihet se ka bërë ndërhyrje.

8.00	Sinjalizimi horizontal				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
8.01	Furnizimi dhe punimi në rrugë i vijave të bardha të plotë (gjerësia 150 mm)	m'	19,446.00		
8.02	Furnizimi dhe punimi në rrugë me vija të bardha të ndërprera (3+3+3 m, me gjerësi 150 mm), pjesa e ngjyrosur e rruges	m'	2,342.00		
8.03	Furnizimi dhe punimi në rrugë me vija të bardha të ndërprera (1+1+1 m, me gjerësi 150 mm), pjesa e ngjyrosur e rruges	m'	199.00		
8.04	Furnizimi dhe punimi në rrugë me shigjeta për lëvizje (me gjatësi 5.00 m)	copë	36.00		
<p>Vërejtje: Ngjyra duhet të jetë mase plastike e ftohtë dy komponenteshe (termoplastike) me rruaza qelqi dhe agragate kundër rreshqitjes, me trashësi të ngjyres në sipërfaqe mbi 3 mm, me koeficient të ndriçimit të retrorefleksionit gjatë natës (thate) i klasit min R3≥150 mcd, në lagështi R<sub>e3</sub> 35 mcd, koeficient të ndriçimit gjatë dites min. B3, β ≥ 0.4, koeficient të ndriçimit në ndriçimin difuz Q2≥100 sipas IS EN 1436, rezistenca ndaj rreshqitjes klasit S2≥50. Ngjyra duhet ta ketë certifikatën e qendrushmerisë sipas standardit UNE – EN 1436:2009 + A1:2009.</p> <p>Ky specifikacion vlen për të gjitha pozicionet e mësipërme të sinjalizimit horizontal të rrugës.</p>					
					€

➡ **Është fshirë kjo pjë**

Bazuar në dokumentet e komisionit, shihet se operatori nuk ka ofruar në ofertën fillestare specifikat teknike për sinjalizimin horizontal, duke përfshirë trashësinë e shtresës, përbërjen e komponentëve, retroreflektivitetin dhe standardet (UNE – EN 1436:2009 + A1:2009).

Megjithatë, AK ka lejuar që operatori të dorëzojë sqarime dhe dokumente shtesë pas hapjes së ofertës, duke përmirësuar ofertën teknike, gjë që shkel nenin 59.4 dhe 72 të LPP-së dhe cenon barazinë mes operatorëve.

#### **Pretendimi i katërt (IV)**

AK ka bërë shkelje edhe të Nenit 59.4 të LPP-së lidhur me Nenin 40 të RrPP-së pasi nuk ka potencuar të gjitha mungesat në ofertën e **GOE FS C ING SH.P.K.; EL-BAU SH.P.K.** pasi i njëjti është i papërgjegjshëm për arsye tjera pasi nuk plotëson kriteret e vendosura në FTD-në e këtij aktiviteti të prokurimit.

GOE është i papërgjegjshëm pasi nuk plotëson kërkesën lidhur me kapacitetet teknike/profesionale më saktësisht kërkesën:

**Lista e pajisjeve - mjeteve të punës që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas Aneksit 7**

**Dëshmia Lista e paisjeve e nënshkruar dhe vulosur original nga OE, të dhënat e paisjeve, Librezat me validitet për makinerin që regjistrohet, Dud , Faturë, Foto për paisjet e tjera. Apo marrveshje makinerisë Originale në mes të Qeradhënësit dhe Qeramarrësit**

Operatori nuk ka dorëzuar fotografi të shumicës së pajisjeve, duke mos plotësuar këtë kriter dhe duke vërtetuar papërgjegjësinë e ofertës.

#### **Pretendimi i pestë (V)**

AK ka bërë shkelje edhe të Nenit 59.4 të LPP-së lidhur me Nenin 40 të RrPP-së pasi nuk ka potencuar të gjitha mungesat në ofertën e **GOE FS C ING SH.P.K.; EL-BAU SH.P.K.** pasi i njëjti është i papërgjegjshëm për arsye tjera pasi nuk plotëson kriteret e vendosura në FTD-në e këtij aktiviteti të prokurimit.

OE EL BAU SH.P.K. anëtar i konsorciumit ka kontribuar me kapacitete profesionale dhe teknike, duke paraqitur inxhinierë, pajisje dhe certifikata ISO në emrin e tij, me qëllim që të plotësohen kriteret e kualifikimit të përcaktuara në dosjen e tenderit në të njëjtën kohë ka deklaruar se nuk do të marrë pjesë në realizimin e asnjë përqindjeje të punimeve (0%).

Ky veprim është në kundërshtim të plotë me parimet e Ligjit për Prokurimin Publik, pasi:

- Nëse një anëtar nuk do të angazhohet në zbatimin e kontratës, atëherë as kapacitetet e tij teknike, njerëzore dhe profesionale nuk mund të llogariten në vlerësimin e ofertës.

Për pasojë, një ofertë që mbështetet në resurse të ofruara nga një anëtar i cili nuk do të marrë pjesë në realizimin e kontratës, është e pavlefshme dhe e pasinqertë, dhe për rrjedhojë duhet të refuzohet.

Kërkojmë që, në përputhje me nenin 108 të LPP-së dhe parimet themelore të ligjshmërisë dhe konkurrencës së ndershme, ky veprim të vlerësohet si shkelje serioze e kriteve të kualifikimit dhe integritetit të ofertës, dhe operatori ekonomik i rekomanduar të skualifikohet si i papërgjegjshëm.

## Pretendimi i gjashtë (VI)

AK ka bërë shkelje edhe të Nenit 59.4 të LPP-së lidhur me Nenin 40 të RrPP-së pasi nuk ka potencuar të gjitha mungesat në ofertën e **GOE FS C ING SH.P.K.; EL-BAU SH.P.K.** pasi i njejtë është i papërgjegjshëm për arsye tjera pasi nuk plotëson kriteret e vendosura në FTD-në e këtij aktiviteti të prokurimit.

GOE është i papërgjegjshëm pasi nuk plotëson kërkesën lidhur me kapacitetet teknike/profesionale më saktësisht kërkesën:

**Lista e pajisjeve - mjeteve të punës që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas Aneksit 7**

### **20. - Cisternë (Autobotë) për karburante;**

Në lidhje me këtë kërkesë GOE ka dorëzuar dëshmi të një "Autobotë me 2 dyer" duke mos e dëshmuar me fotografi e për të cilën dyshojmë se është cisternë e ujit dhe jo për karburante.

## **Pretendimet ankimore ndaj OE Rahovica Commerce SH.P.K.**

### Pretendimi i shtatë (VII)

AK ka bërë shkelje edhe të Nenit 59.4 të LPP-së lidhur me Nenin 40 të RrPP-së pasi nuk ka potencuar të gjitha mungesat në ofertën e **OE Rahovica Commerce SH.P.K.** pasi i njejtë është i papërgjegjshëm për arsye tjera pasi nuk plotëson kriteret e vendosura në FTD-në e këtij aktiviteti të prokurimit.

Gjatë procesit të sqarimit, me kërkesë të vetë Autoritetit Kontraktues, ky operator ka dorëzuar dokumente plotësuese që datohen pas hapjes së ofertave, e cila ka qenë më 07.04.2025.

1.Buldozer min 14 Ton 2 cop Foto OK.pdf	826 612	826 612	2025-06-03 13
2.Eskavator Liebherr 926 28.1 Ton foto OK.pdf	387 002	339 899	2025-06-02 14
3.Eskavator LIEBHERR A904C 22 Ton Pronesi foto OK.pdf	613 653	573 967	2025-06-02 14
4.Eskavator max 8 Ton foto OK.pdf	3 599 276	3 329 595	2025-06-03 13
5.Kamion kiper min 10 m3 Pronesi foto OK.pdf	4 492 872	4 052 885	2025-06-03 13
6.Kamion min 20 m3 5cop Marreshje Foto OK.pdf	4 117 983	4 079 784	2025-06-03 13
7.Ngarkues Liebherr L566 Pronesi.pdf	305 393	305 167	2025-06-03 22
8.Ngarkues Liebherr 576 24T.pdf	1 373 335	1 105 801	2025-06-03 22
9.Damper max 5ton marrveshje.pdf	537 604	493 122	2025-06-03 15
10.Viber Pllak ngjeshese Pronesi.pdf	930 780	833 000	2025-06-03 14
11.Gjysëmrirmorkio Transportuese dhe kamioni.pdf	3 836 124	3 634 855	2025-06-04 10
12.Makine per sheshimin dhe nivelizimin e rruges greder max 6 ton.pdf	669 199	612 698	2025-06-03 12
13.Greder O&K F106 05-122 - VB Pronesi me foto OK.pdf	708 397	695 551	2025-06-03 12
14.Greder F 156 A 15.8T Pronesi me foto OK.pdf	286 928	277 271	2025-06-03 09
15.Cilinder me dhembza Bomag BW 219 Marreshje me foto OK.pdf	428 383	384 537	2025-06-04 10
16.Cilinder vibrues HAMM 3518 - Pronesi me foto OK.pdf	825 246	759 301	2024-11-16 13
17.Cilinder Zhavorit HAMM 3307 HT 7.5T Pronesi Foto OK.pdf	655 910	620 251	2025-06-03 12

18.Cilinder jo vibrues Pronesi foto OK.pdf	577 018	530 991	2025-06-03 13
19.Gjysemrimorkio 01-852-XC Marreshje foto OK.pdf	1 089 917	1 010 709	2025-06-03 12
20.Cistern 05-497-HK Marrveshje foto OK.pdf	670 530	622 743	2025-06-03 16
21.Kamion Sperkates per bitumen dhe emoluzion 05-564-EB Pronesi dud f...	1 020 126	970 055	2025-06-03 10
22.Makine per shperndarjen e emoluzionit MAUS 90A Pronesi foto OK.pdf	1 110 334	1 073 090	2025-06-03 10
23.Geryese Frezë W1200 me nivelizuese digjitale 20.5 T Pronesi.pdf	398 397	357 848	2025-06-03 12
24.Prerese Asfalti.pdf	481 773	433 507	2025-06-03 13
25.Finisher,Asfaltit VOGELE S 1800-2 25.84T Pronesi foto OK.pdf	584 005	541 871	2025-06-03 12
26.Finisher, Asfaltit VOGELE Screed S1800-2 19.7T Pronesi foto OK.pdf	543 975	506 591	2025-06-03 12
27.1.Cilinder Hekur Hekur HAMM HD 90 foto OK Pronesi.pdf	497 354	473 549	2025-01-16 12
27.2Cilinder Asfaltit Hekur Hekur BOMAG 154 AP foto OK Pronesi.pdf	687 410	650 754	2025-06-02 15
28.1.Cilinder Asfaltit Gome Hekur PUMA 169 AV 8T.pdf	486 745	449 505	2025-06-03 22
28.2.Cilinder Gome Hekur Bomag BW 151 Foto OK Pronesi.pdf	1 205 365	1 161 467	2025-01-16 12
29.Instrument per matje te temperatures se asfaltit Pronesi.pdf	404 264	303 910	2025-06-03 13
30.Makineri per vizim krosa Marrveshje +Foto OK Marreshje.pdf	2 529 995	2 497 298	2025-06-02 15
31.Gps per matje gjeodezike Marrveshje World_compressed.pdf	1 373 491	1 334 723	2025-06-04 10
32.Stacion Total Marrveshje Wlorld_compressed.pdf	1 453 107	1 414 009	2025-06-04 10

Nga shqyrtimi i këtyre dokumenteve rezulton se vetëm tri pajisje janë paraqitur me dokumente të datës para hapjes së ofertave, ndërsa të gjitha pajisjet e tjera janë shënuar me data pas hapjes së tyre, pra në periudhën kur është kërkuar sqarimi nga AK-ja.

Ky fakt tregon qartë se është tentuar të manipulohet procesi, duke paraqitur dokumente të përgatitura pas afatit të dorëzimit të ofertave, me qëllim që të krijohet përshtypja se ato kanë ekzistuar më herët.

Neni 72 paragrafi 3 i LPP-së e parasheh qartë këtë çështje: *“3.Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.”*

Në këtë rast, dokumentet e dorëzuara më vonë nga ky operator në fazën e sqarimit nuk mund të verifikohen në mënyrë objektive si dokumente që kanë ekzistuar para afatit të dorëzimit të ofertave. Për më tepër, kontratat e huamarrjes së pajisjeve, të cilave i është referuar AK-ja gjatë vlerësimit, nuk kanë qenë të noterizuara dhe nuk ekziston asnjë provë ligjore që ato të jenë përpiluar para hapjes së ofertave.

### **Pretendimi i tetë (VIII)**

AK ka bërë shkelje edhe të Nenit 59.4 të LPP-së lidhur me Nenin 40 të RrPP-së pasi nuk ka potencuar të gjitha mungesat në ofertën e **OE Rahovica Commerce SH.P.K.** pasi i njëjti është i papërgjegjshëm për arsye tjera pasi nuk plotëson kriteret e vendosura në FTD-në e këtij aktiviteti të prokurimit.

Me rastin e dorëzimit të dokumenteve të kërkuara përmes sqarimit të kërkuar nga ana e AK-së i njëjti ka dorëzuar dokumentet të cilat datojnë pas hapjes së ofertave e cila ka qenë 07.04.2025.

Në mesin e këtyre dokumenteve, vetë operatori ka paraqitur një policë sigurimi për pajisjen “Kamion kiper me kapacitet minimal 20 m<sup>3</sup>”, me tabela të regjistrimit AB601AD, e cila mban datën 08.04.2025, pra pas hapjes së ofertave.



Serial:250358569 | S | agjenti:ST08099 | S-ST08099-171508060 | 06.04.2025 10:44:20 e paradites



Nr. i serisë **25 0358569**  
KOD RAPORTIMI

D2/1/TR1SH02/93494/3491421E1D6278F39C2D3  
7269D8C25EED2



Nr. 1715081 Datë 06.04.2025

**POLICË PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM TË  
MBAJTËSVE TË MJETEVE MOTORIKE PËR  
PËRGJEGJËSINË NDAJ PALËVE TË TRETA**

Kjo provë e qartë tregon se pajisja nuk ka qenë në dispozicion të operatorit në momentin e dorëzimit të ofertës, duke e bërë ofertën e tij të papërgjegjshme në kuptim të dispozitave të LPP-së.

### **Pretendimi i nëntë (IX)**

AK ka bërë shkelje edhe të Nenit 59.4 të LPP-së lidhur me Nenin 40 të RrPP-së pasi nuk ka potencuar të gjitha mungesat në ofertën e **OE Rahovica Commerce SH.P.K.** pasi i njëjti është i papërgjegjshëm për arsye tjera pasi nuk plotëson kriteret e vendosura në FTD-në e këtij aktiviteti të prokurimit.

Me rastin e dorëzimit të dokumenteve të kërkuara përmes sqarimit të kërkuar nga ana e AK-së i njëjti ka dorëzuar dokumentet të cilat datojnë pas hapjes së ofertave e cila ka qenë 07.04.2025.

Kjo dëshkohet edhe me një librezë regjistrimi e dorëzuar për paisjen: Rimorkio me tabela të regjistrimit: 06-405-XB të cilës regjistrimi i skadon me 22.05.2026.



Kjo poashtu konfirmon se ky dokument është i përpiluar pas datës 22.05.2025 pasi për të pasur librezë validitet deri me 22.05.2026 duhet të jetë e regjistruar me 22.05.2025.

Andaj, edhe në këtë rast, dëshkohet qartë papërgjegjësia e ofertës së këtij operatori ekonomik.

### **Pretendimi i dhjetë (X)**

AK ka bërë shkelje edhe të Nenit 59.4 të LPP-së lidhur me Nenin 40 të RrPP-së pasi ka vlerësuar ofertën e **OE Rahovica Commerce SH.P.K.** si ofertë të përgjegjshme edhe pse i njëjti është i papërgjegjshëm pasi nuk plotëson kriteret e vendosura në FTD-në e këtij aktiviteti të prokurimit.

Ky OE është i papërgjegjshëm pasi nuk plotëson kërkesën lidhur me kapacitetet teknike/profesionale më saktësisht kërkesën:

**Kerkesa-3 Një (1) Inxhinier të diplomuar ose Master per menaxhim të pronave, me së paku 5 (pesë) vite përvojë pune pas diplomimit.**

### **3. Edhe Certifikata e Gis**

Ky OE me rastin e ofertimit nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi se inxhinieri posedon Certifikatën Gis. Mirëpo gjatë dorëzimit të dokumenteve për sqarim edhe pse nuk ka qenë kërkesë e AK-së i njëjti ka tentuar që të dorëzoj këtë certifikatë kinse për të dëshmuar se e posedon. Mirëpo kjo certifikatë është e nxjerrë me datë 02.05.2025, pra pas datës së hapjes së ofertave e cila vërteton se gjatë kohës së ofertimit e njëjta nuk ka ekzistuar.

Andaj edhe në këtë rast dëshmohet papërgjegjësia e ofertës së këtij OE.

### **Pretendimi i njëmbëdhjetë (XI)**

AK ka bërë shkelje edhe të Nenit 59.4 të LPP-së lidhur me Nenin 40 të RrPP-së pasi ka vlerësuar ofertën e **OE Rahovica Commerce SH.P.K.** si ofertë të përgjegjshme edhe pse i njëjti është i papërgjegjshëm pasi nuk plotëson kriteret e vendosura në FTD-në e këtij aktiviteti të prokurimit.

Ky OE është i papërgjegjshëm pasi nuk plotëson kërkesën lidhur me kapacitetet teknike/profesionale më saktësisht kërkesën:

**Kerkesa-1 Menaxher i Kontratës projektit - Një (1) Inxhinier të diplomuar të Ndërtimtarisë - drejtimi Konstruktiv, me së paku 7 (Shtatë) vite përvojë pune pas diplomimit.**

**Vendimi me shkrim për emërimin e një menaxher projekti. Vendimi duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vërtetuar nga operatori ekonomik dhe nga Inxhinieri.**

Ky OE me rastin e dorëzimit të ofertës nuk ka dorëzuar vendimin për menaxher të projektit të nënshkruar dhe të vërtetuar nga inxhinieri, mirëpo ka paraqitur vetëm një listë të stafit profesional. Edhe në këtë rast është tentuar që këtë dokument ta dorëzoj me rastin e kërkesës për sqarim të tenderit edhe pse e njëjta nuk është kërkuar nga ana e AK-së, mirepo edhe ky dokument daton pas hapjes së ofertave.

### **Pretendimi i dymbëdhjetë (XII)**

AK ka bërë shkelje edhe të Nenit 59.4 të LPP-së lidhur me Nenin 40 të RrPP-së pasi ka vlerësuar ofertën e **OE Rahovica Commerce SH.P.K.** si ofertë të përgjegjshme edhe pse i njëjti është i papërgjegjshëm pasi nuk plotëson kriteret e vendosura në FTD-në e këtij aktiviteti të prokurimit.

Ky OE është i papërgjegjshëm pasi nuk plotëson kërkesën lidhur me kapacitetet teknike/profesionale më saktësisht kërkesën:

**Kerkesa-4 Një (1) Inxhinier të diplomuar ose Bachelor të Ndërtimtarisë - drejtimi Gjeodezi, me së paku 5 (pesë) vite përvojë pune pas diplomimit. I licencuar nga AKK, licenca valide**

Ky OE ka dorëzuar licencën e gjeodetit të skaduar më datë 03.03.2025, pra në momentin e dorëzimit të ofertave ajo ka qenë jovalide.

Edhe ky fakt dëshmon qartë papërgjegjësinë e ofertës së këtij OE.

### Pretendimi i trembëdhjetë (XIII)

Komisioni i vlerësimit ka bërë shkelje të Nenit 59.1 të LPP-së dhe Nenit 40.1 të RRPP-së pasi të njëjtit janë të obliguar që të vlerësojë dhe krahasojë tenderët e përgjegjshëm sipas kritereve për dhënien e kontratës të përcaktuara në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit, gjithnjë sipas Nenit 40.13 të RRPP-së.

### Pretendimi i katërbëdhjetë (XIV)

AK ka bërë Shkelje të rëndë (Neni 97.1.o të RRPP-së) pasi me provat e mësipërme dëshmohet se kemi të bëjmë me sjellje të gabuar dhe jo profesionale të zyrtarit përgjegjës të prokurimit ndaj kompanisë sonë. Kjo pasi i njëjti është i obliguar sipas Nenit 39.4 të RRPP-së të organizoj punën e komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP.

AK-ja nuk e ka respektuar edhe **nenin 7** të LPP-së, ku edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë.

**Paragrafi 1 i nenit 7** të LPP-së e parasheh qartë që *“Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7* të LPP-së e parasheh që *Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të siguroj: që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse”,* mirëpo AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe **nenin 1** të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Prandaj, faktet dhe rrethanat e lartcekura e vërtetojnë se vendimi i AK-së është i kundërligjshëm, sepse gjatë procedurës së vlerësimit është vendosur në dëm të tenderit/ofertës së OE ankues duke na mohuar të drejtën e ligjshme të shpërblimit me kontratë, pavarësisht faktit se kemi paraqitur tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Andaj duke konsideruar se AK ka vepruar në kundërshtim me aplikimin e dispozitave të lartshënuara të LPP-së dhe akteve nënligjore, ku si pasojë e shkeljeve ka rezultuar me dëmtimin e marrjes së kontratës nga **OE BENI – COM SH.P.K.** pasi jemi ofertues i përgjegjshëm dhe plotësojmë të gjitha kriteret e vendosura në FTD-në e këtij aktivitetit të prokurimit, kërkojmë nga AK të marrë në konsideratë dhe të vlerësojë të gjitha faktet e paraqitura në këtë ankesë dhe duke u udhëhequr nga parimi i ligjshmërisë, barazisë dhe mosdiskriminimit, pavarësisht dhe paanësisht në vendimarrje, i propozojmë të merr këtë:

### **VENDIM**

- **APROVOHET SI E BAZUAR** ankesa e OE **“BENI - COM SH.P.K.”**
- **ANULOHET** Njoftimi mbi Vendimin e AK-së i publikuar me dt. 16.12.2025 në ueb faqe të KRPP-së, dhe lënda të kthehet në RI-VLERËSIM.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi te detyruar te vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente, dhe do të kërkojmë llogari përmes rrugëve ligjore nga të gjitha palët qe kanë marrë pjesë në këtë aktivitet të prokurimit.

## **9. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Operatori Ekonomik ankues në mbrojtje të interesave të tij ekonomike dhe ligjore, rrjedhimisht në rast të vazhdimit të veprimeve kundërligjore do të veprojë me të gjitha mjetet ligjore të lejuara, kërkesës për kompensimin e dëmeve duke përfshirë edhe fitimin e humbur.

## **10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura**

*Ankesës i bashkangjiten në kopje dokumentet, faktet, provat e konstatuara më lartë.*

*Dëshmi 1: Aneksi 1 (Fotografite e pajisjes dhe tiketa, BOMAG BW 225-D3).*

*Dëshmi 2: Aneksi 2 (Certifikata për siguri dhe shëndet në punë e lëshuar nga MPMS).*

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*